



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Received	26	11	8	vit / year
Organ / Agency	Nr. Prot. / No. Prot.	Shtojca / Prilog	Sasia / Quantity	
Organ / Unit	Prot. No.	Appendix		
SKPMSTCK	7157/2018		1111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 304 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Menaxherit të Personelit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
- Arkivit të Këshillit.


Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit

Faqe 1 / 1





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Received Prilapjen / Prodate Received / Delivery	26.11.2018	8	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7157/2018		1/1

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

SEKRETARIATIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	6
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	7
Procedurat Disiplinore.....	8
Procedurat e Ankesave.....	8
Procedurat e Vlerësimit.....	8
Procedurat e Pushimeve.....	8
Procedurat e Transferimit.....	8
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	9
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	10
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	10
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	10
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	10
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	10
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	11
Shënimet/komentet për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	11

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar "Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Mbikëqyrjes" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË SEKRETARIATIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 22.10.2017, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren Nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Rregullore Nr.04/2017 për avancimin dhe transferimin e nëpunësve në Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Vendimi me nr. 1288/2016 i datës 08.12.2016 për emërimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi me nr.1280/2016 i datës 08.12.2016 për emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendim Nr. 458-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit për Çështje Ligjore;
- Vendim Nr. 500-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit të TI;
- Vendim Nr. 541-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Udhëheqësit të Divizionit për Shërbimin e Votuesve;
- Akt emërimit Nr. 664-2011 për pozitën Koordinator i Zyrtareve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve, i datës 24.05.2011;
- Akt emërimit i datës 14.12.2011 për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor;
- Akt emërimit i datës 19.12.2011 për pozitën Zyrtar i Lartë i Bazës së Shënimeve;
- Akt emërimit Nr. 667-2011 për pozitën Zyrtar i Lartë i Shërbimit të Votuesve, i datës 24.05.2011;
- Akt emërimit Nr. 784-2011 për pozitën Zyrtar i Lartë për Informim Publik, i datës 24.06.2011;
- Vendimi me nr.2510/2017 i datës 08.12.2017 për transferimin e nëpunësit prej pozitës Koordinator i Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në pozitën Drejtor i Departamentit për Koordinim në Terren;
- Vendimi me nr.2511/2017 i datës 08.12.2017 për transferimin e nëpunësit prej ushtrues detyre i Departamentin Ligjor, transferohet në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor;
- Vendimi me nr.2512/2017 i datës 08.12.2017 për transferimin e nëpunësit prej pozitës ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative në pozitën Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative;
- Vendimi me nr.2555/2017 i datës 12.12.2017 për transferimin e nëpunësit prej ushtrues detyre i Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve, transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve;
- Vendimi me nr.2556/2017 i datës 12.12.2017 për transferimin e nëpunësit prej pozitës Zyrtarë e Lartë për Informim Publik në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Edukim të Votuesve;

- Ndryshim plotësimi i Akt emërimit për pozitën Drejtor i Departamentit për Koordinim në Terren i datës 08.12.2017;
- Ndryshim plotësimi i Akt emërimit për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor i datës 08.12.2017;
- Ndryshim plotësimi i Akt emërimit për pozitën Drejtor i Departamentit të TI i datës 08.12.2018;
- Ndryshim plotësimi i Akt emërimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve i datës 11.12.2017;
- Ndryshim plotësimi i Akt emërimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Edukim të Votuesve i datës 11.12.2018;
- Vendimi me nr.652/2016 i datës 24.08.2016 deri më 20.05.2017 për pushimin e lehonisë;
- Vendimi me nr.356/2016 i datës 03.05.2018 deri më 03.02.2017 për pushimin e lehonisë;
- Vendimi me nr.1882/2017 i datës 04.10.2017 për pezulim të dakorduar të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil;
- Vendimi me Nr.A 02/08/2017 i datës 10.03.2017 i KPMSHK-së;
- Vendimi me Nr.01/2017 i datës 01.01.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 22.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që është duke u zbatuar. Në këtë institucion janë të punësuar 71 nëpunës civil, ndërsa janë të lira 6 pozita.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil: Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e votuesve, Zyrtare e Lartë për Financa, Zyrtare e Lartë e Përkthimeve, Zyrtar i Lartë i Bazës së të Dhënave-TI dhe Zyrtar i Lartë Komunal-Suharekë, dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara ashtu siç përcaktohet me dispozitat e dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendrorë të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur tre pozita me ushtrues detyre.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimeve për ushtrues detyre, respektivisht Vendim Nr. 458-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit për Çështje Ligjore, Vendim Nr. 500-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Drejtorit të Departamentit të TI dhe Vendim Nr. 541-2013 për caktim të ushtruesit të detyrës të Udhëheqësit të Divizionit për Shërbimin e Votuesve, ka konstatuar që këto pozita kanë qenë me ushtrues detyre që nga viti 2013. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin

civil konstaton se caktimi i ushtruesve të detyrës për periudhë më të gjatë se 3 muaj është në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryeshefin e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të ndërmarr të gjitha veprimet që me rastin e caktimit të ushtruesve të detyrës që të respektohen të gjitha afatet ligjore siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë vitit 2017 me vendime për transferim ka bërë avancimin e pesë (5) nëpunësve civil pa zhvilluar fare procedura të avancimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

E GJETURA 1: Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Vendimi nr.2510/2017 të datës 08.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës Koordinator i Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve, në pozitën Drejtor i Departamentit për Koordinim në Terren, me Vendimin me nr.2511/2017 të datës 08.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre i Departamentin Ligjor, në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, me Vendimin me nr.2512/2017 të datës 08.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative, në pozitën Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative, me Vendimin me nr.2555/2017 të datës 12.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve, me Vendimin nr.2556/2017 të datës 12.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës Zyrtare e Lartë për Informim Publik, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Edukim të Votuesve.

Bazuar në vendimet e lartcekura, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve po gjatë vitit 2017 për pozitat e theksuara me lartë ka lëshuar ndryshim plotësimin e Akt Emërimeve të përhershme për nëpunësit civil të njëjtë, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 5, neni 25, 26 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civil dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores, Nr. 07-2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të anulohet të gjitha Ndryshim dhe Plotësim Akt Emërimet dhe Vendimet për transferim të vitit 2017, të cilat janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr. 07-2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil, si dhe të ndërmarr të gjitha veprimet që procedurat e avancimit të zhvillojë në pajtim me nenin 18 paragrafi 5, nenin 25, 26 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civil

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në bazë të Vendimi me nr. 1288/2016 i datës 08.12.2016 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në bazë të vlerësimit të dosjeve në këtë institucion nuk janë zhvilluar asnjë procedurë disiplinore.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të Vendimit me Nr.1280 të datës 08.12.2016 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar. Gjatë vitit 2017 janë parashtruar dy (2) ankesa dhe për të cilat është vendosur, kundër vendimeve të KZKA ankuesit kanë parashtruar edhe në Këshill për të cilat Këshilli ka nxjerr vendime me të cilat janë konfirmuar si të rregullta vendimet e KZKA-së.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Qendror të Zgjedhjeve evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, 7 nëpunës kanë realizuar pushimin mjekësor dhe në dosje kanë qenë të vendosura shenjat mjekësore, një (1) nëpunës civil ka realizuar pushimin pa pagesë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjes ka qenë këkresa për pushim si dhe vendimi dy(2) nëpunës civilë kanë realizuar pushimin e lehonisë dhe në bazë të shqyrtimit të dosejve kanë qenë të vendosura vendimet, në këtë rast tek procedurat e pushimeve janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë vitit 2017 ka nxjerrë pesë (5) vendime për transferimin e

nëpunësve civil, respektivisht Vendimin me nr.2511/2017 të datës 08.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre i Departamentin Ligjor, në pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, me Vendimin me nr.2512/2017 të datës 08.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë Informative, në pozitën Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative, me Vendimin me nr.2555/2017 të datës 12.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës ushtrues detyre Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbimin e Votuesve, me Vendimin nr.2556/2017 të datës 12.12.2017 ka transferuar nëpunësin civil prej pozitës Zyrtare e Lartë për Informim Publik, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Informim dhe Edukim të Votuesve, vendime këto që janë në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që me rastin e transferimit të kujdeset që të zbatohet neni 28 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka të punësuar 71 nëpunës civil prej tyre 60 janë shqiptar, 10 serb, 1 turk, prej 71 të punësuar nëpunës civil 21 janë të punësuar femra ndërsa 50 janë meshkuj ndërsa në këtë institucion nuk ka asnjë nëpunës civil të punësuar nga persona me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 71 nëpunësve civil të punësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve 21 janë të punësuar femra ndërsa 50 janë të punësuar meshkuj çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Kryeshefin e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 71 nëpunësve civil të punësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve asnjë prej tyre nuk është i punësuar nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një duhet me qenë person me nevoja të veçanta.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryeshefin e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, një nëpunës ka gëzuar të drejtën e pezullimit të dakorduar, dy (2) nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit dhe për të gjitha këto procedura janë ndjekur procedurat ligjore.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë pozitë të nëpunësit civil dhe ndonjë post publik.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj asnjë nëpunësi civil nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë vitit 2017 nuk ka përgatitur planin e trajnimeve, megjithatë është konstatuar se janë zhvilluar 231 trajnime të gjitha përmes projekteve ku janë përfshi i gjithë stafi i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për vitin 2017 Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka përgatitur planin e trajnimeve.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe udhëheqësin e personelit, që të përgatisin planin vjetor të trajnimeve për nëpunësit civilë, dhe që të kihet parasysh që trajnimin ta ndjekin një numër sa më i madh i nëpunësve civil, ashtu siç përcaktohet me nenin 35 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse kjo do të shërbej në ngritjen profesionale të tyre.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vijimin në punë e mban në formë fizike. Po

ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me akt emërimet ndërsa shtesë në pagën bazë gëzojnë vetëm nëpunësit civil të TI-së.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar dy (2) vendim të Këshillit i cili është zbatuar. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikqyrjes, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ;
- Udheheqesit të Personelit në Sekretariatit të KQZ;
- Arkivit të KPMSHCK

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit



Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Sabile Avdyli